



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

RELACION

PËR

**“DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË GODINËS KU USHTRON AKTIVITETIN
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
KORÇË, ME NR. 4/33-ND3 PASURIE, ME SIPËRFAQE 1400 M2”**

Bashkia Korçë ka në pronësi pasurinë nr. 4/33-ND3, e llojit ndërtesë + truall, me sipërfaqe 1400 m², ZK 8564, me adresë Lagjia 17, Rruga “Mario Poziu”, Korçë, në bazë të VKM Nr. 1532 datë 19.11.2008 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës”* e ndryshuar.

Në këtë objekt ushtron veprimtarinë administrative Instiucioni i Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Korçë. Kjo drejtori është nën varësinë administrative të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në zbatim të Ligjit Nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”* dhe VKM-së Nr. 554 datë 31.07.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”*

AKPA-ja nuk ka në pronësi asnjë ndërtesë ku të ushtronte aktivitetin Drejtorisë Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Korçë. Kontrata e huapërdorjes e lidhur midis Bashkisë Korçë dhe AKPA-së, me afat 3 vjeçar, bazuar në VKB 24 dt. 25.02.2021 *“Dhënie me huapërdorje të godinës ku ushtron aktivitetin Drejtorisë Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Korçë, me nr. 4/33-nd3 pasurie, me sipërfaqe 1400 m²”*, ka përfunduar.


Me shkresë Nr. 183/1 Prot dt. 30.01.2024, protokolluar në Bashkinë Korçë me Nr. 851 Prot. dt. 31.01.2024, AKPA-ja i është drejtuar Bashkisë Korçë, duke kërkuar rinovimin e kontratës.

Sa më lart, bazuar në nenin 9 pika 12 gërmat a) "Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj dhe c) "E drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës" dhe pika 1.6 gërma a) "E drejta e lidhjes së kontratës" si dhe gërma e/I e nenit 54 "Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin e pronave të tretëve" të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civil, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë dhënien në përdorim, me kontratë huapërdorje të godinës ku ushtron veprimtarinë administrative Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Korçë, identifikuar si pasuria me Nr. 4/33-ND3, me sipërfaqe 1400 m², për një afat 3 vjeçar, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aflësive.

Bashkangjitur këtij relacioni:

Gen-Plan i pasurisë nr.4/33-ND3 ZK 8564.

Drejtores e Përgjithshme: A. Qeramixhi (Dishnica)



KRYETAR I BASHKISË

Sotiraq Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____ .02.2024

PËR

“DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË GODINËS KU USHTRON AKTIVITETIN DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË, ME NR. 4/33-ND3 PASURIE, ME SIPËRFAQE 1400 M2”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) dhe c); në nenin 54 pika 1.6 gërma a) dhe gërma e/1) të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në nenet 901-912 të Kodit Civil, dhe VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtererore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës”, e ndryshuar dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien me huapërdorje, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, të godinës ku ushtron veprimtarinë administrative Drejtoria Rajonale e Ofritit të Formimit Profesional Publik Korçë, me nr. 4/33-ND3 pasurie, ZK 8564, me sipërfaqe 1400 m2, sipas planimetrisë bashkangjitur, për një afat 3 vjeçar.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë për lidhjen e kontratës së huapërdorjes.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

GEN PLAN

Zona Kadastrale 8564, pasuria nr 4/180, bashkia Korçë

HUA MARRRESI : AGJENSIA KOMBETARE E
PUNESIMIT DHE AFTESIMIT PROFESIONAL
Siperfaqja, = 1400 m²



HARTOI : A. GREMI

Arber
Gremi

Digitally signed by Arber
Gremi
Date: 2024.02.06 10:49:10
+0700'



BASHKIA KORÇE

KR 851
PROT
DATA 31/01/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVENr. 183/1 Prot.Tiranë, më 30.01.2024

Lënda: Kërkesë për lidhjen e kontratës së huapërdorjes së Godinës ku ushtron aktivitetin Institucioni Publik “Qendra e Formimit Profesional Publik, Korçë”.

BASHKISË KORÇË ✓

Për dijëni: QËNDRES SË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK, KORÇË

Në zbatim të Ligjit 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Urdhërit të Ministrit nr. 10168/1 prot, datë 05.06.2023, “Për miratimin e strukturës dhe organikave të Qendrave të Formimit Profesional Publik”, Qendrat e Formimit Profesional Publik janë institucione nën administrimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

AKPA ka për detyrë të garantojë cilësinë e këtij administrimi, dhe për këtë, infrastruktura e ambienteve ku realizohet procesi mësimor merr rëndësi parësore.

Përsa më sipër, duke qënë se AKPA nuk ka në pronësi asnjë ndërtesë ku Qendra e Formimit Profesional Publik Korçë të ushtrorë aktivitetin e saj publik, dhe kontrata e huapërdorjes e lidhur me Bashkinë Korçë me Vendimin nr. 24, datë 25. 02. 2021 me afat 3 vjet ka përfunduar, kërkojmë nga ana juaj lidhjen e një kontrate të re Huapërdorje me të njëjtat kushte për një afat të dakordësuar ndërmjet palëve.

Mbetemi në pritje të konfirmimit nga ana juaj të propozimit si më sipër, për të vijuar më tej me procedurat konform akteve normative.

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA

